



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 552 Prot.

Tiranë, më 25.3. 2025

URDHËR

Nr. 613, datë 25.3. 2025

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS SË NJOHJES DHE NJËSIMIT TË PROGRAMEVE TË
STUDIMIT, KURSEVE INSTITUCIONALE, CERTIFIKATAVE DHE DIPLOMAVE TË
LËSHUARA NGA INSTITUCIONET ARSIMORE JASHTË SHTETIT PËR PERSONELIN
USHTARAK TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; në pikën 2, shkronjën “f”, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 113, të ligjit nr.44/2015 “ Kodi i procedurave administrative të RSH”, i ndryshuar; në nenin 17, 18 dhe 20 të ligjit nr.59/2014, datë 12.06.2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr.765, datë 08.06.2021 “Për miratimin e dokumentit ‘Politika e Arsimit dhe Kualifikimit të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të RSH për përparim në gradë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Tabelës së Njohjes dhe Njësimit (TNJNJ), të programeve të studimit, kurseve institucionale, certifikatave dhe diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore jashtë shtetit për personelin ushtarak të Forcave të Armatosura.
2. Njohja dhe njësimi i programeve të studimit, kurseve institucionale, certifikatave dhe diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore jashtë shtetit për personelin ushtarak të FA të bëhet sipas tabelës së njësimit “Aneksi A”, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
3. Pranë Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), të ngrihet dhe funksionojë “**Komisioni i Njohjes dhe Njësimit të Kurseve (KNJNJK)**” me përbërjen si vijon;
 - a. Rektori / Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura
 - b. Zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë,
 - c. 1 (Një) përfaqësues nga Akademia e Forcave të Armatosura,

Kryetar
Anëtar
Anëtar

c) Një përfaqësues nga Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Anëtar
d) Një përfaqësues nga DMBNJSH në MM	Anëtar
dh) Një përfaqësues nga Drejtoria e Personelit në SHPFA	Anëtar
e) Nënoficeri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së	Anëtar

4. Sekretar i **Komisioni i Njohjes dhe Njësimit të Kurseve (KNJNJJK)** caktohet një përfaqësues nga Akademia e Forcave të Armatosura (AFA).
5. AFA-ja, në koordinim me struktura të tjera mësimore përgjegjëse për arsimimin dhe kualifikimin e personelit ushtarak oficer dhe nënoficer, të hartojë një rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Kurseve (KNJNJJK), brenda **muajit prill 2025**.
6. KNJNJJK të shqyrtojë kërkesat e ardhura nga QPR-ja, strukturat e Forcave të Armatosura nga palë ose/dhe persona të interesuar për këtë proces. Për çështje informacioni/dokumentacioni, ky komision bashkërendon punën dhe thërret specialistë të fushave nga struktura të tjera përgjegjëse në fushën e arsimimit dhe menaxhimit të personelit në FA.
7. KNJNJJK **nuk trajton** kërkesat që lidhen me zbatimin e udhëzimit të përbashkët të MM dhe MAS me nr.5103, datë 22.09.2023, “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, me karakter ushtarak, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”.
8. KNJNJJK të shqyrtojë edhe kërkesat për kurset/trajnimet që nuk janë të përfshira në tabelën e njësimit të kurseve që kryhen në institucione arsimore dhe stërvitore në vendet e NATO-s/ose edhe partnere që plotësojnë kriteret mësimore të njëvlershme me kurset institucionale në FARSH, si dhe të hartojë praktikën për ministrin e Mbrojtjes për njohjen, njësimin dhe konvertimin e tyre me notë, me qëllim vlerësimi në karrierë.
9. Urdhrat e ministrit të Mbrojtjes, si më poshtë, shfuqizohen:
 - a) nr.178, datë 27.01.2017, “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të kurseve institucionale të kryera jashtë shtetit nga personeli ushtarak i Forcave të Armatosura” dhe tabelës përkatëse nr.189/2, datë 27.01.2017, i ndryshuar;
 - b) nr.795, datë 14.05.2015, “Për ngritjen e bordit të ekuivalentimit të kurseve institucionale të kryera jashtë shtetit nga personeli ushtarak i Forcave të Armatosura, i diplomave të lëshuara nga institucionet e larta arsimore ushtarake brenda vendit dhe i diplomave të lëshuara nga institucionet e larta arsimore jashtë vendit”;
 - c) nr. 2012, datë 11.12.2015, “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në vite”.
- 10) Sektori i Web- it në Ministrinë e Mbrojtjes të ngarkojë këtë urdhër të shoqëruar me tabelën përkatëse dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit në faqen zyrtare, në rubrikën “Rekrutime e karriera”, në zërin “Arsimimi në FA”.

- 11) Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Akademia e Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, komandat e forcave kryesore dhe strukturave mbështetëse, strukturat e vartësisë së MM-së dhe SHPFA-së, Qendra e Personel-Rekrutimit, Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së dhe Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes.
- 12) Ndjekin zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Pirro Vengu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 613 / Prot. 1

Tiranë, më 25.3.2025

ANEKSI A

TABELA

E NJOHJES DHE NJËSIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALETË KRYERA JASHTË SHTETIT NGA PERSONELI USHTARAK I FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Emërtimi i Programit të Studimit/ Kursit të zhvilluar	Përshkrimi	Kohëzgjatja	Kriteret & Kodi i gradave	Programi i studimit/Kursi institucional me të cilin njësohet	Kodi i arsimimit	Grada që të mundeson në Shqipëri
I. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË SHBA PËR OFICERË							
1	Military Academy/Naval Academy/Air Force Academy/Akademia Ushtarake West Point/Akademia Ushtarake e Forcave Detare/Akademia Ushtarake e Forcave Ajrore.	Edukon trajnon dhe frymëzon Korpusin e Kadetëve të SHBA-së, për tu bërë lider me karakter, të përkushtuar ndaj vlerave të ushtrisë dhe të gatshëm për ti sherbyer ushtrisë dhe kombit.	4 vite akademike	Kadet Maturant Student Ushtarak Ushtar I	Programet e ciklit të parë të studimeve bachelor	Kadet K-0	N/Toger/ N/Lejtënant
2	Officers Candidate School (OCS)/Shkolla e Kandidatëve për Oficerë.	Shkolla e Kandidatëve për Oficerë (OCS) është e projektuar për të trajnuar personelin civil dhe rekrutet e rinj në parimet bazë ushtarake, disiplinën dhe aftësitë profesionale themelore, me qëllim titullimin e tyre oficerë.	1 vit akademik	Student i vitit të fundit OF-0 NCO të kenë diplomë bachelor	Shkollë ushtarake	K-0 K-1	N/Toger/ N/Lejtënant
3	Basic Officer Courses/Kurset bazë të oficerit (sipas specialiteteve).	Pergatit oficeret e rinj, ne programin baze te oficerit, sipas specialiteteve, dhe i pergatit ata në marrjen e detyrave komanduese ne specialitetet perkatese.	5-7 muaj	OF-0 OF-1	Kursi Baze i Oficerit (KBO)-Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-1 K-2	Toger-Kapiten/ Lejtënant Kapiten lejtënant

4	U.S. Army Aviation Maintenance Officer Course	Program. Kursi i Oficerëve të Mirëmbajtjes së Aviacionit (AMOC) prodhon aftësitë e nevojshme për të menaxhuar një program të mirëmbajtjes së aviacionit në nivel kompanie dhe batalioni. I ofruar si një kurs rezident gjashtë-javor, AMOC është krijuar për të trajnuar një individ mbi "si" të administrojë një Program Mirëmbajtjeje.	6 javë	OF-1 OF-2	Kursi i Avancuar i Oficerit KAO	K-2	Kapiten Forcë Ajrore
5	Inter-European Air Force Academy (IEAFA) Squadron Officers School	Programi siguron edukim/module me tema në lidhshmëri, komunikim, siguri kombëtare, konflikt i armatosur, si dhe tema mbi profesionin e forcave të armatosura në përgjithësi.	2 javë	OF-1 OF-2	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)-Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	K-2 K-3	Kapiten Major
6	Captain's Career Courses/Kurset e Kapitenit të Karrierës (sipas specialiteteve), Aviation Captain's Career Course, Squadron Officer School (Kursi i Oficerit të Skuadronit të Forcës Ajrore)	Kursi është projektuar për togerë dhe kapitenë të rinj për të shërbyer në pozicionet e komandantit të kompanisë dhe oficerit të shtabit në batalione sipas specialiteteve perkatese.	7-10 muaj	OF-1 OF-2	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)-Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	K-2 K-3	Kapiten Major
7	International Maritime Officer Course (IMOC) (Kursi Nderkombëtar i Oficerit Detar)	Kursi i jep mundësinë studentëve për të studiuar organizimin ushtarak, planëzimin, menaxhimin dhe operacionet shumëdimensionale të Forcave Detare	3-4 muaj	OF-1 OF-2	Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	K-2 K-3	Kapiten Lejtnant
8	Command and General Staff College (Kolegji i Komandës dhe Shtabit të FT), Naval Staff College (Kolegji i Shtabit të FD), Air Command and Staff College (Kolegji i Komandës dhe Shtabit të FAj).	Ky kurs është projektuar për major, për të shërbyer në pozicionet e komandantit të batalionit, oficerit të shtabit në nivel brigade, force dhe shtab I përgjithshëm, sipas specialiteteve perkatese.	10-12 muaj	OF-3 OF-4	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP)-Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	K-5 - K-6	N/kolonel Kolonel
9	Army War College, Naval Command College, Air War College (Kolegji i Luftës i FT, FD, FAj).	Ky program u jep oficerëve të përzgjedhur një mundësi për të zgjeruar kualifikimet e tyre profesionale përmes pjesëmarrjes në kurrikulën e kolegjit, të studiojnë, hulumtojnë dhe shkruajnë për tema me rëndësi për interesat e sigurisë të kombëtare si dhe situatave të sigurisë globale.	Sipas programit të shkollës. 12-13 muaj	OF-4 OF-5	Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)-Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-6 K-7	Kolonel Gjeneral Brigade
10	National Defense University's Dwight D. Eisenhower School for National Security and Resource Strategy (ES), College of Information and Cyberspace (CIC), College of International Security Affairs (CISA), and National War College (NWC)	Ky program përfshin studime të mendimit të strategjisë kombëtare, doktrine dhe operacione të përbashkëta, çështje të sigurisë ndërkombëtare, lufta jokonvencionale, kundër-terrorizm.	Sipas programit të shkollës. 1 vit akademik	OF-4 OF-5	Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)-Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-6 K-7	Kolonel Gjeneral Brigade

II. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË SHBA PËR NËNOFICERË

1	Basic Leader Course (BLC)	The Basic Leader Course (BLC) ofron një mundësi për ushtarët/nënoficerët për të fituar njohuritë, aftësitë, dhe përvojat e liderit të nevojshme për të drejtuar në nivel grupi dhe skuadre. BLC përgatit Ushtarë IV//Nëntetarë për detyrat dhe përgjegjësitë si Nëntetarit dhe Tetarit.	3 javë	OR-4 OR-5	Kursi Fillestar i Nënoficerit (KFN) Kursi Bazë i Nënoficerit (KBN)	L-3 L-4	Nëntetar & Tetar
2	Advance Leader Course/ Senior Leader Course (ALC/SLC)	ALC/SLC)ky kurs formëson tre Kompetencat e Themelore të Nënoficerit Si lider (SLC NCO-C3) përgatit Nënatarët dhe Tetarët për detyrat si komandant skuadre dhe Zv/komandant toge.	2-3 javë	OR-5 OR-6	Kursi Bazë i Nënoficerit (KBN) Kursi i Avancuar i Nënoficerit (KAN)	L-4 L-5	Tetar & Rreshter
3	Master Leader Course (MLC)	MLC është një program mësimor me kurrikulë intensive, që përgatit nënoficerët me gradën Rreshter dhe i aftëson ato si nënoficerë për stërvitjen dhe operacionet duke rritur aftësinë e tyre për të aplikuar të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në procesin e vendim marrjes ushtarake.	3 javë	OR-7	Kursi i Lartë i Nënoficerit (KLN)	L-6	Kapter
4	Sergeant Major Course (SMC)	SMC është një program mësimor 1 vit i plotë akademik me kurrikulë intensive, që përgatit nënoficerët me gradën Kapter dhe i aftëson ato si nënoficerë drejtues për stërvitjen dhe operacionet dhe kryenënoficerë në nivel batalioni/regjimenti dhe brigade.	3 muaj kurs para-përgatitor dhe 10 muaj vit akademik	OR-8 OR-9	Kursi i Kryekapterit	L-7	Kryekapter
5	Inter-European Air Force Academy (IEAFA) Noncommissioned Officer Course	Ky kurs zhvillohet Akademisë së Nënoficerëve të USAF (NCOA) i cili përgatit nënoficerët si lider dhe për të marrë detyra dhe përgjegjësi më të avancuara drejtuese dhe menaxhuese. Ky kurs është vijim i Arsimit Ushtarak Profesional (PME) Institucional i krijuar për nënoficerët me gradë Nëntetar, Tetar, Rreshter që marrindetyra të larta drejtuese.	5 javë	OR-5 OR-6 OR-7	KBN KAN KLN	L-4 L-5 L-6	Tetar Rreshter Kapter
6	Inter-European Air Force Academy (IEAFA) Noncommissioned Officer Course (Kursi i Akademisë së N/Oficerit)	Forcimi i bashkëpunimit të sigurisë dhe përsheptimi i ndërveprimit nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe marrëdhënieve të qëndrueshme.	Sipas programit të shkollës.	OR-5 OR-6 OR-7	Kursi i Avancuar i Nënoficerit	L-5 1&2	Rreshter

III. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË GJERMANI PËR OFICERË

1	Offizier-Brief der Deutschen Marine uberveicht (Kursi i oficerit të marinës).	Këshillim i komandantin e anijes për çështjet detare. Ju jeni përgjegjës për të gjitha detyrat detare dhe detare në anije, të tilla si puna në pajisjet e radarëve të lundrimit, lundrimi sipas dukshmërisë së radarit në të ashtuquajturin navigacion me mjegull dhe analizimi dhe vlerësimi i dokumenteve gjeofizike dhe oceanografike.	Sipas programit të shkollës.	Kadet Student Ushtarak	Shkollë e marinës	K - 1	Nëntoger
2	Offizierlehrgang (Kursi bazë i Oficerit).	Këtu oficerët e rinj përgatiten profesionalisht dhe përgjithësisht ushtarakisht për detyrën e tyre të parë drejtuese. Një kurs i tillë është tetë-mujor	8 muaj	OF-0 OF-1	Kursi Baze i Oficerit (KBO)-Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-1 K-2	Toger Kapiten
3	Kompaniecheflehrgang (Kursi Komandantit të Kompanisë).	Kursi aftëson oficerët e karrierës (të përkohshëm nuk i lejohen të marrin pjesë), për Komandant Kompanie dhe midis të tjerave i autorizon ata që të jenë "Shefa disiplinare" në kompani për efektivat e tyre.	6-8 javë	OF-0 OF-1	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-2	Kapiten
4	Inter-European Squadron Officer School (IESOS) / Shkolla Ndërvropiane për oficer skuadrilje	Programi siguron edukim/module me tema në lidhshëm, komunikim, siguri kombëtare, si dhe tema mbi profesionin e forcave të armatosura në përgjithësi.	Sipas programit të shkollës.	OF-1	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-2	Kapiten
5	Basislehrgang Stabsoffizier (BLS) /Kursi i.Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	Ky kurs përgatit kapitenët për të punuar në shtab. Dhe është i detyrueshëm për t'u bërë Major dhe gjithashtu që të mund të aplikohet më vonë për kurest LGAI dhe ose LGAN, në varësi të rezultateve të arritura.	3 muaj	OF-2	Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	K-3	Major
6	Lehrgang Generalstabs/Admiralstabsdienst International (Akademia e Drejtimit për tre llojet e Forcave-LGAI).	Trajnimi i Oficerëve të Shtabit, ofron mundësinë për të marrë trajnim akademik pasuniversitar në nivelin taktik. Trajnimi i Oficerëve të Komandave dhe Shtabeve, niveli taktik dhe operativ.	1 Vit akademik	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP)	K-5	N/kolonel Kolonel
7	Lehrgang Generalstabs/Admiralstabsdienst National (Akademia e Drejtimit për tre llojet e Forcave-LGAN).	Trajnimi i Oficerëve të Shtabit, ofron mundësinë për të marrë trajnim akademik pasuniversitar në nivelin taktik. Trajnimi i Oficerëve të Komandave dhe Shtabeve, niveli Taktik, Operacional Strategjik (ushtarake) dhe të Grand Strategy (përfshirë diplomaci dhe politikë).	2 Vite akademike	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) - Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	K-5 K-6	N/kolonel Kolonel

8	Master of Arts in International Security Studies (MISS)	Trajnimi i Oficerëve të Shtabit, ofron mundësinë për të marrë trajnim akademik pasuniversitar në nivelin taktik. Trajnimi i Oficerëve të Komandave dhe Shtabeve, niveli taktik dhe operativ.	1 vit akademik.	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP)	K-5	N/kolonel
9	Executive program in Advance Security Studies (Programi Ekzekutiv ne Studime te Thelluara te Sigurise)	Trajnimi i komandës dhe shtabit të përbashkët, niveli operativ dhe strategjik, zhvillohen fusha e operacioneve, lidershipit, Historisë, madhënieve ndërkombëtare dhe politika e jashtme	3 muaj	OF-5	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-7	Gjeneral Brigade

IV. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË ITALI PËR OFICERË

1	Akademia Ushtarake në Modena.Shkolla per oficere te specialitetit te llojeve, armeve dhe sherbimeve te ndryshme	Parashikon formimin baze te oficerave a) te specialitetit te llojeve, armeve dhe sherbimeve te ndryshme (kembesori, kavaleri, artileri, xhenio, nderlidhje), b) transport dhe logjistike, c)inxhinieri, d) mjekesi, farmaci, veterineri, e) polici ushtarake, f) karabinieri	2-3 vite akademike Për degët e mjekësisë kohëzgjatja 7 vite akademike (6+1)	Parauniversitar	Programet e ciklit të parë të studimeve	K-1	N/toger Toger
2	Scuola Ufficiale Carabinieri (Shkolla e Karabinierëve, Romë) Coso di applicazione (Kursi i Aplikimit, Romë)	Te pergatise oficeret qe vijne nga Akademia e Modenas. Kursi zhvillohet nepermjet leksioneve universitare, leksione teorike e praktike ne lendet teknike-profesionale dhe edukim fizik. Ky program ndiqet nga studentet qe kane perfunduar 2 vjecarin prane Akademise Ushtarake te Modenas	3 vite akademike	OF 0	Programet e ciklit të parë të studimeve	K-1	N/toger Toger
3	Shkolla e Aplikimit ne Torino (Oficere te Forcave Tokesore)	Ploteson formimin e oficerave qe vijne nga Akademia Ushtarake e Modenas, te specialitetit te llojeve, armeve dhe sherbimeve te ndryshme (kembesori, kavaleri, artileri, xhenio, nderlidhje), transport dhe logjistike, polici ushtarake	1-3 vite akademike	OF 0	Akademi ushtarake	K-1	N/toger Toger
4	Accademia Navale Livorno Akademia Ushtarake Detare Livorno	Ky cikël studimesh zhvillohet ne dy periudha te cilat perfshijne studime universitare dhe veprimtari teknike-profesionale. Ne perfundim te periudhes se pare trevjecare, studentet diplomohen ne shkenca detare (Scienze marittime e navali). Menjehere me pas studentet ndjekin Kursin e Aplikimit (Corso Applicativo), i cili zgjat 2 vite akademike dhe zhvillohet ne Universitetin e Pizes.	5 vite akademike (3 Akademia Livorno+2 Universiteti i Pizes)	Kadetë/studentë ushtarakë	Programet e ciklit të parë të studimeve	K-1	N/toger Toger (Lejtnant)
5	Universiteti i Pizes Kursi i Aplikimit	Kryhet menjehere pas perfundimit te tre viteve te studimit ne Akademine Detare te Livornos.	Sipas programit të shkollës. 2 vite akademike	OF-0	Universiteti/Shkolla e marinës	K-1	Toger

6	Corso Regolare per Ufficiali del Ruolo Naviganti Normale / delle Armi Normale (Kursi per oficerë pilot / Faj) Akademia e Aviacionit Ushtarak në Pozzuoli.	Përgatitja e studenteve me njohuritë bazë për t'u bërë pjesë e FA në nivel ekzekutiv/drejtues sipas specialitetit. Në përfundim të këtij cikli studimesh, studentet diplomohen në Shkencën Aeronautike dhe marrin patentën e pilotit të aeroplanit (Ruolo naviganti normale).	Sipas programit të shkollës. 3 vite akademike	Kadetë/studentë ushtarakë	Programi studimi bachelor	K-1	N/toger Togër
7	Istituto Superiore di Stato Maggiore Interforze (ISSMI) (Instituti i Lartë i Shtabit të Përgjithshëm Gjithëarmësh INTERFORZE) Qendra për studimet e larta të mbrojtjes (CASD)	Qëllimi i këtij kursi është të zhvillojë dhe përkrahë më tej njohuritë profesionale dhe kulturore të oficerëve (major - nënkolonel) dhe të përgatisë ata për të kryer detyra në nivele të larta drejtuese në Komandat e Forcave, në Shtabin e Përgjithshëm, si dhe në komandat e shtabëve të NATO-s.	Sipas programit të shkollës. 9 muaj	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSH) - Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	K-5 K-6	N/kolonel Kolonel
8	Istituto Alti Studi per la Difesa-IASD (Qendra e Studimeve të Larta për Mbrojtjen)	Qëllimi i këtij kursi është aftësimi i drejtuesve të nivelit të lartë (kolonel - gjeneral brigade) nëpërmjet analizimit të thelluar të problematikave komplekse në fushën e drejtimit, duke u fokusuar kryesisht në fushën e mbrojtjes, të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikën e aleancave.	5 muaj për personelin e huaj, 1 vit akademik për personelin vendas	OF-5 OF-6	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM)	K-7	Kolonel Gjeneral Brigade

V. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË GREQI PËR OFICERË

1	Akademia Ushtarake e Forcave Tokësore dhe Detare, Athinë.	Zhvillon programe studimi bachelor sipas fushave, merr pjesë edhe personeli i huaj, para fillimit të shkollës bëhet një vit parapërgatitor plus gjuha greke, pas titullimit oficer dhe gradimit nëntoger oficerët e rinj ndjekin kurset bazë sipas specialiteteve "Shkolla e Përgatitjes së Oficerëve"	1 vit përgatitor 4 vite akademike	Student Ushtarakë Kadetë	Programet e ciklit të parë të studimeve bachelor	K-0	Nëntoger Nënlejtant
2	Shkolla e përgatitjes së specialiteteve për Ushtrinë në Selanik	Arsimohen nëpërmjet programeve të studimit bachelor sipas specialiteteve si mjeksi, jurisi, informatikë, psikologji, etj	1 vit përgatitor 4 vite akademike	Student Ushtarakë	Programet e ciklit të parë të studimeve bachelor	K-0	Nëntoger
3	Shkolla e Infermierisë në Athinë	Arsimohen nëpërmjet programeve të studimit bachelor në mjekësi për infermiere ushtarakë.	1 vit përgatitor 5 vite akademike	Student Ushtarakë	Programet e ciklit të parë të studimeve bachelor	K-0	Nëntoger
4	Shkolla e Zbatimit (Shkolla e Trupës-Specialitetet) (KBO) në Athinë	Zhillohet pas Akademisë së forcave dhe ofron programe të profilit sipas specialiteteve	6 deri 9 muaj sipas specialiteteve	OF-0 OF-1	Kursi Bazë i Oficerit (KBO)- Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K 1 K 2	Toger Kapiten
5	ΑΝΩΤΑΤΗ ΔΙΑΚΛΑΔΙΚΗ ΣΧΟΛΗ ΠΟΛΕΜΟΥ (Kolegji i Lartë i Luftes për tre llojet e Forcave- "ADHISPO"), Selanik	Zhillohen për arsimimin e gradave major, nuk ka ndikim në karrierë për vendasit, kurrikulat kanë njohuri për nivelin operativ dhe operativ-strategjik	Kursi zgjat një vit akademik	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSH)-Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	K-5 K-6	N/kolonel-Kolonel Kap. Rang. II Kap. Rang. I

6	ΣΧΟΛΗ ΕΘΝΙΚΗΣ ΑΜΥΝΑΣ (Shkolla Mbrojtjes Kombëtare-"SETHA"), Athine	Zhillohen për arsimimin e gradave nënkolonel , nuk ka ndikim në karrierë për vendasit, kurrikulat kanë njohuri për nivelin-strategjik	Kursi zgjat një vit akademik	OF-4 OF-5	Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) - Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-6 K-7	Kolonel Gjeneral Brigadë
7	International Senior Course on Defence Studies (Kursi i Lartë Nderkombëtar për Studimet e Sigurisë), Athine	Kurs ndërkombëtar për studime strategjike	Kursi zgjat 3 muaj	OF-5	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-6 K-7	Kolonel Gjeneral Brigade

VI. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN PËR OFICERË NË TURQI

1	Milli Savunma Üniversitesi (MSÜ) Üniversitesi Kombëtar i Mbrojtjes (UKM) Kara/Deniz/Hava Harp Okulları (Shkollat Ushtarake për FT, FD, FAj)	Degët që zhvillohen në AFT në Turqi janë; inxhinieri kompjuterike; inxhinieri elektronike dhe komunikimi; inxhinieri ndërtimi; inxhinieri mekanike; menaxhimi i mbrojtjes; histori; marrëdhënie ndërkombëtare.	1 vit përgatitor 4 vite akademike	Maturant Ushtarak Student Ushtar I	Programet e ciklit të parë të studimeve	Bachelor	Nëntoger Nënlejtënant
2	Studime në Fakultetin e Mjekësisë "Gülhane"	Në tre vitet e para, jepen njohuritë themelore të mjekësisë, vitet e katërta dhe të pesta të arsimit janë kushtuar stazheve klinike ku studentët njihen me të gjitha degët e mjekësisë moderne dhe se viti i gjashtë i fakultetit u është kushtuar arsimit të internëve.	1 vit përgatitor & gjuha turke 6 vite akademike	Maturant Ushtarak Student Ushtar I Civil	Bachelor & KBO	Bachelor K-1	Nëntoger/ Nënlejtënant
3	Milli Savunma Üniversitesi (MSÜ) Üniversitesi Kombëtar i Mbrojtjes Sınıf Okulları Temel Kursu (Kursi Bazë i Oficerit), sipas specialiteteve	Trajnimi ofrohet për përdorimin e mjeteve luftarake të këmbësorisë dhe stërvitjen e gjuajtjes, stërvitjen luftarake dhe fizike, trajnimin e mbrojtjes, zbulimit dhe sulmit. I ndryshëm me specialitete	6, 9 dhe 12 muaj sipas specialiteteve	OF-1	Kursi Baze i Oficerit (KBO)- Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-1 K-2	Toger Kapiten
4	Milli Savunma Üniversitesi (MSU) Üniversitesi Kombëtar i Mbrojtjes Kara/Deniz/Hava Harp Enstitüsü(Instituti i Luftës FT, FD, FAj)	Trajnimi i Oficerëve të Shtabit, ofron mundësinë për të marrë trajnim akademik pasuniversitar në nivelin taktik. Trajnimi i Oficerëve të Komandave dhe Shtabeve, niveli taktik dhe operativ.	1 vit akademik	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHp)- Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	K-5 K-6	N/kolonel-Kolonel Kapiten i Rangut II Kapiten i Rangut I
5	Milli Savunma Üniversitesi (MSÜ) Üniversitesi Kombëtar i Mbrojtjes Müşterek Harp Enstitüsü (Instituti i Përbashët i Luftës)	Trajnimi i komandës dhe shtabit të përbashkët, niveli operativ dhe strategjik, zhvillohen fusha e operacioneve, lidhshiptit, Historisë, madhënieve ndërkombëtare dhe politika e jashtme	4 muaj	OF-4 OF-5	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-7	Gjeneral Brigade

6	Kursi i specializimit të Pilotëve të avioneve pa pilotë(UAV). Qendra Stërvitore Baykar në Kesan,Turqi.	Kurikula e këtij kursi është gjithëpërfshirëse në aspektin teknik dhe teorik, mundëson personelin e certifikuar të jetë në gjendje të drejtojnë mjetet ajrore pa pilot, të bëjë analizë të thelluar përdorimit ushtarak të këtyre mjeteve.	4 muaj	OF-1	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-2	Kapiten
7	Kursi i për Teknik Mekanik të UAV për oficerë. Qendra Stërvitore Baykar në Kesan,Turqi.	Kurikula e këtij kursi është gjithëpërfshirëse në aspektin teknik dhe teorik, mundëson personelin e certifikuar të jetë në gjendje të bëjë mirëmbajtjen e mjeteve ajrore pa pilot, si dhe të bëjë analizë të thelluar përdorimitoperacional të këtyre mjeteve.	4 muaj	OF-1	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-2	Kapiten

VI. LISTA E KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN PËR NËNOFICERË NË TURQI

1	Kursi i për Teknik Mekanik të UAV për Nënoficerë. Qendra Stërvitore Baykar në Kesan,Turqi.	Kurikula e këtij kursi është gjithëpërfshirëse në aspektin teknik dhe teorik, mundëson personelin e certifikuar të jetë në gjendje të bëjë mirëmbajtjen e mjeteve ajrore pa pilot, si dhe të bëjë analizë të thelluar përdorimitoperacional të këtyre mjeteve.	4 muaj	OR-6	Kursi i Avancuar i Nënoficerit (KANO)	OR7	Rreshter
2	Kursi për Opertor Ngarkese Qendra Stërvitore Baykar në Kesan,Turqi.	Kurikula e këtij kursi i mundëson personelit të certifikuar të jetë në gjendje bëjë vendosjen në gatishmëri të mjeteve, sistemeve të prodhimit të imazheve por edhe përdorimin e sistemeve kinetike të armatimit	30 ditë	OR-5	Kursi Bazë i Nënoficerit (KBN)	OR6	Tetar

VII. LISTA E KURSEVE INSTITUCIONALE QE ZHVILLOHEN NE KANADA

1	Command and Staff Course (Kursi i Komandës dhe Shtabit)	Kursi jep njohuri teorike dhe praktike në nivel kompanie në lloje të ndryshme luftimi dhe njohuri të përgjithshme për batalionin	Sipas programit të shkollës.	OF-1 OF-2	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-2	Kapiten
2	Army Operation Course (Kursi i Operacioneve të FT)	Kursi konsolidon njohuritë e kompanisë dhe zhvillon funksionet e shtabit të batalionit.	Sipas programit të shkollës.	OF-2	Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	K-3	Major

VIII. LISTA E KURSEVE INSTITUCIONALE QE ZHVILLOHEN NE AUSTRI

1	Akademia Ushtarake Wiener Neustad	Kursi jep njohuri teorike dhe praktike në nivel toge dhe te përgjithshme edhe per kompanienë.	Sipas programit të shkollës.	Parauniversitar	Programet e ciklit të parë të studimeve bachelor	K-1	N/toger
2	Kursi i Komandantit të Kompanisë	Kursi konsolidon njohuritë e kompanisë dhe zhvillon funksionet e shtabit te batalionit.	Sipas programit të shkollës.	OF-1	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO)	K-2	Kapiten

IX.LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË BRITANINË E MADHE PËR OFICERË

1	Royal Military Academy, SANDHURST, AIR & NAVY/Akademia Ushtarake Mbreterore	Trajnimi dhe edukimi bazë i oficerëve për të zhvilluar lidshimin tek kadetët duke zgjeruar karakterin, intelektin dhe kompetencat e tyre profesionale në nivelin e kërkuar nga një oficer ushtrie në emërimin e parë	1 vit akademik	Student Ushtarakë	Kursi i Përgatitjes së Oficerit (KPO)	K-1	N/toger Toger
2	Initial Officer Training AIR & NAVY	Për të siguruar që oficeri i ri është gati për fazat e mëpasshme të trajnimit të specializuar, pasi ka përfunduar trajnimin fillestar sipas standardeve të përcaktuara dhe ka fituar një vlerësim të mjedisit detar.	Sipas programit të shkollës.	Student Ushtarakë	Kursi i Përgatitjes së Oficerit (KPO)	K-1	N/toger Toger
3	Advanced Command & Staff Course, ACSC (Kursi i Avancuar i Komandës e Shtabit)	Të përgatisë oficerët për emërimin në nivelin e lartë në nivelin OF 3/OF 4 e lart, duke zhvilluar aftësitë e tyre komanduese, analitike dhe komunikuese dhe duke ofruar një kuptim dhe njohuri të bordit për operacionet e përbashkëta	Sipas programit të shkollës.	OF-3-OF-4	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHS)- Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	K-5 K-6	N/kolonel Kolonel
4	Kursi per Sigurine Globale/International Security Course	Sudimeve të sigurisë në planet, ju do të zgjeroni kuptimin tuaj konceptual kur mendoni për çështjet dhe kërcënimet e sigurisë, ju do të ndërtoni aftësitë e nevojshme për të negociuar në mënyrë efektive kërkesat shpesh konkurruese për sigurimin e njerëzve, shteteve dhe mjedisit natyror në një kontekst kompleks global.	Sipas programit të shkollës.	OF-4	Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)-Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-6 K-7	Kolonel-Gjeneral Brigade
5	Royal College of Defense Studies/Kolegji Mbreteror per studime te mbrojtjes, Londër	Të përgatisë oficerët e lartë dhe udhëheqësit e ardhshëm për përgjegjësi të larta në organizatat e tyre përkatëse duke zhvilluar fuqitë e tyre analitike, njohuritë për mbrojtjen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe vizionin strategjik.	Sipas programit të shkollës.	OF-5	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-7	Gjeneral Brigade
6	International Lieutenant Course, HMS Collingwood (Navy)	Për t'u siguruar oficerëve të marinës grup aftësish lundrimi dhe luftimi të oficerëve të rinj të luftës me një përvojë të mëparshme në det dhe që do të sigurojë një bazë për trajnime më të specializuara lundrimi dhe/ose luftarake.	16 javë	OF-1 OF-2	Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO), Specialiteti Detari	K-2 K-3	Toger-Kapiten

X. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË ESTONI/BALLTIK PËR OFICERË

1	Kursi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Bashkuar	Të përgatisë oficerët për emërimin në nivelin e lartë në nivelin OF 3/OF 4 e lart, duke zhvilluar aftësitë e tyre komanduese	Sipas programit të shkollës.	OF-3	Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHS)	K-5	N/kolonel
2	High Command Studies Course (Kursi i Studimeve për Komandat e Larta)	Të përgatisë oficerët e lartë dhe udhëheqësit e ardhshëm për përgjegjësi të larta për mbrojtjen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe vizionin strategjik.	Sipas programit të shkollës.	OF-4 OF-5	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-7	Gjeneral Brigade

XIV. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN NË FRANCË PËR OFICERË

1	L'Ecole de guerre / War College (Shkolla e Luftës)	Ky program përfshin studime mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare, vendimarrjen politike për veprime ushtarake, doktrinë dhe operacione të përbashkëta të nivelit kombëtar dhe NATO, çështje të sigurisë ndërkombëtare dhe politik-berjen e shtetit, konfliktet e armatosura dhe lufta kundër-terrorizmit.	1.5 vit akademik	OF-4-OF-5	Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)-Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-6 - K-7	Gjeneral Brigade
---	---	---	------------------	-----------	--	-----------	------------------

XV. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN PËR OFICERË NË QENDRAT E NATO-S

1	NATO Defense College (Kolegji i NATO-s Romë)	Programi fokuson rëndësinë e udhëheqjes efektive dhe ndikimin e tij në organizata, veçanërisht në një kontekst shumëkombësh dhe multikulturor siç është NATO.	Sipas programit të shkollës.	OF-5	Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLMS)	K-7	Gjeneral Brigade
---	--	---	------------------------------	------	---	-----	------------------

X. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KURSEVE INSTITUCIONALE QË ZHVILLOHEN PËR OFICERË NË KOSOVË

1	Akademia e Mbrojtjes/Qendra e studimeve Universitare	Program studimi në shkencë ushtarake, zhvillohet në bashkëpunim me Institutin e Teknologjisë Rochester (Rochester Institute of Technology) në Kosovë në gjuhën angleze në periudhë 4 vjeçare	4 vite akademike	Kadet Student Ushtarak Maturant Ushtar I	Programet e ciklit të parë të studimeve bachelor	Kadet K-0	N/Toger/
	Kursit për Lider Luftarak (KLL)	Programi shndërron ushtarin IV në nëntetar.	4 javë (170h)	OR-4 OR-5	Kursi i Fillestar i Nënoficerit (KLN)	L-3	Nëntetar
	Kursit të Avancuar për Lider (KAL)	Programi hedh themelet bazë për formimin e nënoficerit	7 javë (227h)	OR-5 OR-6	Kursi i Bazë i Nënoficerit (KBN)	L-4	Tetar
	Kursit të Lartë për Nënoficer (KLN)	Programi zhvillon bazat e formimit të nënoficerit në nivel strukture	8 javë (277h)	OR-6 deri OR-8	Kursi i Lartë i Nënoficerit (KLN)	L-5 L-6	Rreshter Kapter
	Kursit për Rreshter Major (KRRM)	Programi I avancuar për të kompletuar nënoficerin në rolin e këshilltarit të Komandës.	6 muaj (600h)	OR-8 OR-9	Kursi i Kryekapterit (KKK)	L-7	Kryekapter

XI. KURSE/TRAJNIME TË TJERA

1	Për të gjitha kurset/trajnimet që nuk janë të përfshira në këtë tabelë dhe kryhen në institucione arsimore dhe stërvitore në vendet e NATO-s/ose edhe partnere që plotësojnë kriteret mësimore të njëvlefshme me kurset institucionale në FARSH, Komisioni për Njohjen dhe Njësimin e Programeve të Studimit/Kurseve, të hartojë praktikën për Ministrin e Mbrojtjes për njohjen, njësimin dhe konvertimin e tyre me notë me qëllim vlerësimi për karrierë.
2	Programet ushtarake që ofrojnë diplomë bachelor ose master sipas ligjit për arsimin e lartë, njësimi i tyre me diplomën analoge në RSH, bëhet sipas procedurës në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 5103, datë 22.09.2023.

MINISTRI**PIRRO VENGU**